



Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, Kodin e punës së KEK sh.a, si dhe në bazë të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik si dhe nevojave emergjente të paraqitura për plotësimin e vendeve të lira të punës në Divizionin e Prodhimit të Qymyrit të KEK-ut, UD Kryeshefi Ekzekutiv i KEK-ut autorizon Drejtorin e Burimeve Njerëzore, më 20.09.2024 që të publikojë ofertën për pozitat e mëposhtme:

KONKURS

Titulli i pozitës:	<u>Manipulues i shiritave transportues, Manipulues i hinkës fushore dhe Manipulues i kabinës II</u>
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës (Divizioni i Prodhimit të Qymyrit)
Numri i referencës:	10-20.09.2024
Tipi Akt Emërimit të punës:	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012 dhe UA01/2024
Titulli i mbikëqyrësit:	I raporton Prijësit të etazhës, Inxhinierit të ndërrimit, Udhëheqësit të sektorit dhe Menaxherit të Departamentit të Qymyrit, Djerrinës, Etj.
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga:	Minimumi 656 Euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	220
Vendi i punës:	Divizioni i Prodhimit të Qymyrit - Obiliq

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Bartësi i vendit të punës **Manipulues i shiritave transportues** ka për obligim të përcjellë me vëmendje punën e pajisjeve ngasëse të stacionit veprues – shiritit transportues gjatë ndërrimit. Kontrollon pajisjet përcjellëse të stacionit veprues dhe pastrimin e tij. Duhet të ketë njohuri të mjaftueshme në lidhje me shiritat e gomuar (të tenton të bëjë centrimin) në qoftë se shiriti devijon majtas apo djathtas, të lajmëron përgjegjësit e Departamentit të Mirëmbajtjes. Komandon me pajisjet ngasëse të stacionit veprues – shiritit transportues. Është i obliguar që para çdo startimi të stacionit veprues – shiritit transportues, të shtypë sirenën alarmuese. Në raste të rrezikut nga zjarri duhet të din të përdorë aparatet për fikje të cilat janë të vendosura në çdo stacion veprues apo shirit transportues.

Bartësi i vendit të punës **Manipulues i hinkës fushore** para lëshimit në punë të shiritit transportues është i obliguar të vërteton se a janë rrotat e hinkës fushore në binar, që shiriti të mos prek konstruksionin, që tereni për transport të hinkës fushore të jetë i pastër, që kabloja e bllokadës të mos jetë e këputur apo e dëmtuar. Obligohet që rregullisht të kujdeset për pastrimin e pesë fushave para dhe prapa hinkës fushore, stacionit kthyes, të kujdeset për funksionimin e gërryesit “V”, të gërryesit të tamburit dhe lëvizjes së shiritit brenda kufijëve të lejuar mbi tambur. Është i obliguar që t’ia dorëzon në gjendje të rregullt ndërrimit vijues hinkën fushore dhe stacionin kthyes dhe t’ia paraqesë gojarisht të gjitha problemet që janë paraqitur gjatë turnit (pranim/dorëzimi i detyrës). Pastrimi përrreth si dhe nën hinkën ngarkuese dhe stacionin kthyes bëhet kur shiriti transportues është i ndalur – jashtë punës, për shkak të sigurisë. Manipuluesi i hinkës fushore nuk guxon të hyp në vende të rrezikshme dhe t’iu ekspozohet rreziqeve atje ku mund t’i kanoset rreziku për jetë, posaçërisht kur shiriti vetëlëvizës dhe shiriti transportues janë në punë. Për pastrimin e pajisjeve dhe vendeve të caktuara manipuluesi duhet të ketë vegla adekuate. Është i detyruar t’i njoh sinjalet e zërit dhe të dritës të cilat ia jep manipuluesi i shiritit vetëlëvizës dhe ato: Një herë shkurt “Ndal”; dy herë shkurt “Mbrapa”; tri herë shkurt “Përpara”; Sinjali me ndërprerje “Kalim i lirë”. Sipas nevojës me urdhëresë të udhëheqësve, pastron edhe në vendet tjera të punës. Përgjigjet për moszbatimin e plotë të rregullave të mbrojtjes teknike në pajtim me Ligjet në fuqi, Rregulloret, Udhëzimet Administrative, me theks të veçantë atyre nga siguria në punë, si dhe Rregulloret e brendshme të KEK sh.a.

Bartësi i vendit të punës **Manipulues i kabinës II Er**, para fillimit të punës duhet të pajiset me të gjitha mjetet e mbrojtjes në punë. Pas leximit të librit të pranim/dorëzimit nga turni i mëparshëm, kontrollon pajisjet sinjalizuese dhe komanduese të kabinës. Të gjitha prishjet të cilat eventualisht ndodhin, manipuluesi lajmëron prijësin e etazhës dhe kërkon prej shërbimit për mirëmbajtje që të evitohen para fillimit të punës. Prishjet që nuk arrihet të evitohen brenda turnit do t’i shënon në ditarin e punës dhe do të kërkon evitimin e tyre. Është i obliguar t’i njoh sinjalet e zërit dhe dritës: Një herë shkurt “Ndal”; dy herë shkurt “Mbrapa”; tri herë shkurt “Përpara”; Sinjali me ndërprerje “Kalim i lirë”. Në fillim të punës duhet ta vërteton lidhjen me Kabinën 1. Gjatë transportit të Ekskavatorit, manipuluesi i kabinës 2 kujdeset për pozitën e kabinës kurse gjatë punës kujdeset për përqëndrimin e punës së kabinës 2 dhe ngarkesës në SHVL ose në ngarkesën direkt në hinkën fushore, e cila gjendet në shiritin transportues të etazhës. Rregullisht kontrollon gjendjen e instrumenteve (V dhe A - metrit). Punën e kabinës 2 e harmonizon me karakteristikat tekniko-teknologjike të Ekskavatorit rotorik të cilat manipuluesi duhet t’i njoh. Gjatë transportit të Ekskavatorit rregullisht kujdeset edhe për kablion furnizuese. Gjersa Ekskavatori punon, manipuluesi i kabinës 2 nuk guxon ta lëshojë vendin e punës ose të punon tjera punë të cilat e pengojnë atë. Obligohet që të zbaton plotësisht rregullat e mbrojtjes teknike në punë, Ligjin e xehetarisë si dhe rregullat e KEK-ut të harmonizuara me Ligj. Përgjigjet për mirëmbajtjen e pastërtisë së krahut II, rrethanën (krahut III dhe IV) si dhe sipas urdhëresës së prijësit, udhëheqësit të sektorit, inxhinierit të ndërrimit dhe Menaxherit sipas nevojës, duhet të pastron edhe vendet tjera. Sipas nevojave të prodhimit dhe urdhëresës gojore apo me shkrim nga prijësi i etazhës, inxhinieri i ndërrimit, udhëheqësi i sektorit apo Menaxheri, punëmarrësi duhet të punon edhe në vend tjetër të punës në kuadër të profesionit.

Autorizimet

Është i autorizuar të manipulon me pajisjet komanduese të stacionit veprues – shiritit transportues gjatë ndërrimit. Të vepron sipas rregullave të mbrojtjes në punë në pajtim me Ligjet në fuqi, Rregulloret, Udhëzimet Administrative, e me theks të veçantë atyre nga siguria në punë, si dhe Rregulloret e brendshme të KEK sh.a. Të mos lejon qasje në kabinën komanduese (stacionin veprues) të personave të paautorizuar. Vendi i punës do të jetë në Departamentin e Serviseve, Djerrinës, Qymyrit (varësisht ku sistemohet punëtori).

Në rast rreziku për shiritin ose jetën e tij ose të tjerëve, duhet menjëherë ta ndalon shiritin me anë të një ndërprerësi (pulle - taste) të vendosur në distanca jo të mëdha në shirit transportues për ndalim të dhunshëm dhe për këtë ta njofton Prijësin e etazhës. Nëse vëren se shiriti transportues shkon me një anë nga tamburi kthyes, është i autorizuar që këtë ta rregullon vetë nëpërmjet rregullatorit ose ta njofton axhustatorin gjegjësisht prijësin tij.

Në rast rreziku për vetë manipuluesin si dhe në raste lëndimesh në sektorin e tij të punës, manipuluesi e ndalë punën deri të kryhen hetimet e shkakut të aksidentit. Është i autorizuar që të mos e lëshojë kabinën 2 në punë nëse gjendja e pajisjes nuk i plotëson kushtet kryesore të rregullave teknike për punë

I raporton: Prijësit të etazhës, Inxhinierit të ndërrimit, Udhëheqësit të sektorit dhe Menaxherit të Departamentit përkatës.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet

Shkollimi: Të ketë të kryer shkollën e mesme profesionale, Drejtimi i xehtarisë.

Profili: Teknik i xehtarisë, Teknik i minierave.

Të ketë integritet, etikë dhe ndershmëri profesionale, njëherësh duhet të jetë komunikues efikas;

Të ketë shkathtësi të mira personale dhe komunikuese si dhe duhet të jetë i/e aftë për punë ekipore dhe individuale.

Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit të tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- Aplikacionin e shkarkuar nga web faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online të vegëza: **“Ngarko Aplikacionin e plotësuar”**
- Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e shkollës së mesme teknike - Drejtimi Xehtari** (ose **Certifikatën e përfundimit të shkollës së mesme teknike - drejtimi xehtari ose diplomën Teknik i Minierave**) e skanoni në një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale 5 MB) dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online të vegëza **“Ngarko dëshmitë e kualifikimit”**. Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

Mënyra e aplikimit

Aplikimi është online, ngarkoni dokumentet sipas kërkesave në konkurs. Aplikimi juaj është i kompletuar vetëm nëse e merrni e-mailin konfirmues. Për çdo paqartësi dhe për siguri në aplikim kontaktoni në numrin e telefonit: 038 501-401-2671, por mund të shkruani edhe në e-mailin (ofertapune@kek-energy.com) për të vërtetuar aplikimin tuaj (vetëm nëse nuk keni pranuar e-mailin konfirmues).

Njoftimi me rezultatin e konkursit publik

Lista e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për praninë do të shpallet në tabelën e shpalljes në KEK, por kandidatët do të njoftohen individualisht me rezultatin e këtij konkursi duke e respektuar Udhëzimin administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik.

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve:

Testimi me shkrim vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë;

Intervista deri në njëzet (20) pikë;

Jetëpërshkrimi (CV) deri në dhjetë (10) pikë.

Testimi me shkrim do të bëhet në formë elektronike ashtu që vlerësimi do të jetë automatik kurse CV vlerësohet pas përfundimit të testimit online ku pikët e grumbulluara dërgohen tek secili kandidat (testi me shkrim dhe ESEJA).

Procesi i testimit dhe intervistimit për kandidatët e suksesshëm me qëllim të transparencës, do të monitorohet nga kamerat.

KEK-u fton të gjithë të interesuarit, në veçanti ato të gjinisë femërore, të aplikojnë për pozitat e publikuara.

Për më shumë informata për pozitat e lartpërmendura vizitoni web-faqen: www.kek-energy.com, ikona ‘Shpallje’ dhe mund ta shkarkoni aplikacionin për pozitën që dëshironi të aplikoni.

Në rast të pikëve të barabarta në fund të testimit (me shkrim dhe me gojë) përparësi do të kenë kandidatët nga komuna e Obiliqit dhe zonat tjera të rrezikuara konform ligjit nr. 05/l-044.

Vërejtje:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes si në vijim: **Nëse nuk e deklaroni që anëtar i familjes së ngushtë ju punon në KEK, në cilëndo fazë që vërtetohet, aplikacionet e juaja do të refuzohen.**

Aplikacionet pas afatit nuk do të pranohen, ndërsa ato të mangëta ose që nuk janë në formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen.

Kandidati i suksesshëm do të sistemohet në pozitën për të cilën ka aplikuar sipas kësaj shpalljeje dhe në afatin prej 3 (tri) viteve nga dita e kontratës së parë nuk ka të drejtë ri-sistemimi në vend tjetër të punës, përveç në raste të jashtëzakonshme me lejimin e KE të KEK.

Kalendari i përafërt: brenda 25 ditësh testi me shkrim, brenda 25 ditësh intervistat me gojë dhe njoftimi final brenda 30 ditësh nëse nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë sipas UA01/2024.

Data e aplikimit deri më 07.10.2024 ora 24:00

Prishtinë, 20.09.2024



Divizioni i Burimeve Njerëzore